

## Information

Kantonsspital Baden AG  
CH-5404 Baden

Anästhesie-Sprechstunde  
Telefon +41 (0)56 486 31 46  
ipas.chirurgie@ksb.ch

www.ksb.ch

## Sjellja para dhe pas një operacioni në KSB për fëmijë

Të dashur prindër dhe fëmijë

Ju përmes bashkëveprimit tuaj mund të kontribuoni për atë, që të i evitoni efektet anësore të pakëndshme të cilat janë të mundshme pranë secilit trajtim në anesteziologji. Ju lutemi na ndihmoni, që të i evitojmë rastësitë, në atë mënyrë që Ju të i përfillni rregullat vijuese të sigurisë:

### Të qenit esëll

Kohërat e shkurtra të te qenit esëll fëmijës tuaj i rrisin mirëqenien para dhe pas operacionit

Po që se nuk jeni marrë vesh ndryshe, vlejné rregullat vijuese të te qenit esëll:

- Ardhja në ditën e operacionit

#### Foshnjat (deri 1 vit moshe)

- ↳ Zgjoni fëmijën tuaj natën dhe jepini qumësht natyral 4 orë para hyrjes në operacion apo gji 3 orë para hyrjes në operacion.
- ↳ Nëse tani fëmija juaj është mësuar me çaj/ujë, i jepni 1 orë para hyrjes të pijë lëng të pastër si çaj të ëmbëlsuar ose ujë (pa qumësht/ajkë, pa tul).

#### Fëmijët (>1 vit moshë)

- ↳ Zgjoni fëmijën tuaj 1 orë para hyrjes në operacion, dhe jepini të pinë çaj të ëmbëlsuar apo ujë (pa qumësht/ajkë, pa tul).
- ↳ Maksimalisht lejohen 200 ml qumësht/qumësht me çokolatë deri në 4 orë para hyrjes.
- ↳ Ushqimi i fortë janë të lejuar deri me 6 orë para hyrjes në operacion.
- Ardhja një ditë para operacionit:
  - ↳ Fëmija juaj nuk është i detyruar të vjen esëll, nëse nuk është urdhëruar ndryshe.

### Medikamentet vetjake

Në ditën e ardhjes sillini të gjitha medikamentet të cilat i merr fëmija juaj.

Jepini fëmijës tuaj medikamentet e veta të mëngjesit siç vijon:

### Vaksinimet

Vaksinimet mund të sjellin deri tek efektet anësore dhe njëherit të ndryshojnë gjendjen e përgjithshme të fëmijës së Juaj. Prandaj mu për këtë arsye rekomandohet që në mes të vaksinimit dhe operacionit që duhet kryer, repsektivisht anestezisë, të mbahet një distancë kohore sigurie.

- 3 Javë pas vaksinimit kundër Shytave, Fruthit, Rubeolës, Lia e dhëve (Variçela), Ethet e verdha.
- 1 Javë pas vaksinimit kundër Difterisë, Tetanusit, Kolla e mirë (Pertusiti), Paralizisë së fëmijës (Poliomyelitisi), Haemophilus influenza Tip B, Hepatitisi A/B, Viret humane Papiloma, Gripi (influenca), Pneumokoku, Meningokoket, Meningoencefaliti i para-verës, Tërbimi, COVID.

Në qoftë se data e operimit të fëmijës së Juaj, pas kryerjes së një vaksinimi bjen në periudhën e distancës kohore të sigurisë, ne ju lutemi Ju, të na kontaktoni në patjetër, që në atë mënyrë të mundemi të përshtatim terminin e operacionit. Por vaksinimi duhet patjetër të kryhet siq edhe është planifikuar me atë rast. Pas një operacioni/anestezie ne ju rekomandojmë të mbani një distancë kohore sigurie prej një jave deri në vaksinimin e ardhshëm.

### Stolitë, gjërat me vlerë dhe ndihmesat e shikimit

- Leni stolitë dhe gjërat tjera të vlefshme në shtëpi
- Mjetet komunikuese elektronike mund të e shkurtojnë ditën në spital, mirëpo mund të humbin lehtë. Vendosni

me kujdes mbi këto. Nëse tek fëmijët më të rritur është planifikuar një anestezi lokal, guxon të merrni një aparat muzikorë me vete (MP3-Player, Smartphone me qasje telekomunikative) në sallë të operacionit. Në rast humbje apo dëmtimi të tyre refuzohet çfarëdo dëmshpërblimi.

- Pirsingu mund të çon deri te djegia. Po që se mund të hiqet leni ato në shtëpi. Përndryshe Ju duheni të i tërhiqni vëmendjen mjekëve dhe mjekëve për këtë.
- Ju lutemi keni kujdes që fëmija juaj të vjen pa grim në sallë të operacionit.
- Syzat dhe lentat kontakti nuk guxojnë të sjellën në sallë operacioni. Përrjashtim: në rast të paaftësisë së madhe të shikimit, fëmijët më të rritur guxojnë të hynë me syza në OP. Në rast humbje apo dëmtimi të tyre refuzohet çfarëdo dëmshpërblimi

### Përcjellja prindërore në sallë të operacionit

Në KSB ekziston mundësia e përcjelljes së fëmijës në departamentin e operimit nga njëri prind. Prania e njërit prind për shumë fëmijë është qetësuese. Pos fëmija juaj ka rënë në gjumë, Ju do e lëshoni departamentin e operimit nën përcjelljen e punonjësve vullnetarë, në mënyrë që ekipi i operimit të punon i papenguar më tutje. Informata të mëtutjeshme gjenden në broshurën „Përcjellja prindërore në sallën e operimit”. Rastet urgjente dhe fëmijën të moshës nën një vjeçare nuk mund të përcjellën.

### Në ditën e ardhjes

- Ju lutemi, sipas moshës, sillni lodra, kukulla, veshje, pluhur qumështi dhe mashtues me vete.
- Nga ana personelit kujdestarë do kontrollohet qenia esëll dhe gjendja shëndetësore si dhe do të bëhen matjet e domosdoshme (shtypja e gjakut, pesha etj.)
- Normalisht para operimit fëmijës tuaj do ti jepet një lëngë qetësimi.

### Pas operacionit

- Pas operacionit fëmija juaj do të kalon një kohë të caktuar në dhomën për zgjim me kujdes intensiv.
- Gjatë kësaj kohe njëri prindër guxon të e përcjellë fëmijën në dhomën e zgjimit, derisa ai të vendoset në klinikën e fëmijëve.
- Gjatë mobilizimit të parë të fëmijës tuaj, ai mbështetet nga një infermier/e. Ju lutemi prisni udhëzimin e personelit shoqërues.

### Rregullat e sjelljes pas intervenimeve ambulante

- Varësisht nga intervenimi është e mundur, që fëmija juaj në të njëjtën ditë të lëshohet në shtëpi.
- Ju lutemi vini re, që lëshimi mund të zgjasë deri vonë në mbrëmje.
- Për lëshim duhet të plotësohen pikat vijuese: gjendja e të te qenit i zgjuar sipas moshës, mobilizim pa probleme, ushqyerje normale pa vjellje, pa dhimbje të forta.
- Pas lëshimit keni kujdes, që fëmija juaj në 24 orët vijuese pas operacionit të heq dorë nga sporti dhe ngarkesat e larta fizike.
- Problemet në shtëpi: Nëse keni probleme në shtëpi, të tilla si, dhimbje të forta, të vjella, ndiheni keq, ose nëse keni vërejtur gjakderdhje, telefononi 056 486 21 11 (zyra qendrore e KSB-së) dhe kërkoni që te bisedoni me kryemjekun e klinikës së fëmijëve.

Po që se fëmija juaj sëmuret para operacionit, atëherë ju lutemi të kontaktoni mjekun anestezi nën numrin e telefonit 056 486 31 44. Në qoftë se termini i operacionit duhet patjetër të shtyhet, atëher në atë rast ju lutemi të lajmrohemi në sekretariatit e klinikës e cila kryen operacionin, me sa të është shëndoshë fëmija juaj.

### Miratimi dhe vërtetimi

I/e nënshkruari/ja vërteton, që rregullat e lartë përmendura i ka lexuar dhe kuptuar. Për pasojat të cilat mund të rrjedhin nga mosrespektimi i këtyre rregullave, spitali kantonal Baden AG nuk mund të merr përgjegjësi për ato.

Baden, .....  
(Data)

.....  
(Nënshkrimi Pacientja/Pacienti/Prindërit apo përfaqësuesi ligjorë)